



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR SHPLLJEN E HAPJES SË PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR KATËR POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, ka vendosur *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjithsej për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.*

Procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për secilin nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, janë hapur me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

- a) me Vendimin nr.174, datë 28.05.2020, për një pozicion të lirë, në Gjykatën e Apelit Durrës;
- b) me Vendimin nr.177, datë 28.05.2020, për një pozicion të lirë, në Gjykatën e Apelit Korçë;
- c) me Vendimet nr.184 dhe nr.185, datë 28.05.2020, për dy pozicione të lira, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka *shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, për të marrë pjesë në këto procedura ngritjeje në detyrë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, në një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kriterëve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, duke e identifikuar atë përmes numrit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues, për secilin nga pozicionet e lira, është është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë. - Ky afat përfundon më datë 15.06.2020.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, për secilin nga pozicionet e lira, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimet e tij nr.174, nr.177, nr.184 dhe nr.185, datë 28.05.2020.

Kujdes:

- 1) Në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret e ligjës, *pavarësisht faktit nëse ka kandiduar me parë në procedura të tjera për ngritjen në detyrë, procedura këto që nuk janë finalizuar ende.*
- 2) Çdo kandidat, në respektim të kufizimit të përcaktuar në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të kandidojë për ngritjen në detyrë *për jo më shumë se tre pozicione të lira, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020¹, qofshin ato edhe në të njëjtën gjykatë.*

Ky njoftim është publikuar më datë 29.05.2020.

¹ Më datë 28.05.2020, përveç katër procedurave për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur edhe disa procedura për ngritjen në detyrë në gjashtë gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, si dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur disa procedura për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.